



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Kosovës
Komisioni për Integritim Evropian
Mbledhja nr. 03
Prishtinë, më 03. 03. 2008
Ndërtesa e Kuvendit, ora 11:00, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Lutfi Haziri, Džezair Murati, Edita Tahiri, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova ndërsa munguan Hydajet Hyseni dhe Branislav Grbić.

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi.

Sabiha Shala – Agjensioni për Integritim Evropian ZKM
Floreta Kabashi - Agjensioni për Integritim Evropian ZKM
Avni Zuk – NDI
Blerim Vela - OSCE
Federica Domanin – European Commission Liaison Office To Kosovo

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi, kryetare e Komisionit me këtë

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhje e kaluar,
2. Miratimi i Fushëveprimtarisë së Komisionit,
3. Nxjerrja e Rregullores së punës së Komisionit,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i fushëveprimtarisë së Komisionit

Zylfije Hundozi njoftoi anëtarët e Komisionit me propozimin e bërë nga Edita Tahiri që emërtimi fushëveprimtari të zëvendësohet me emërtimin program.

Edita Tahiri tha se do të ishte mirë që në tekstin e fushëveprimtarisë të bëhet shqiprimi i fjalëve monitorim, kooperim, bashkëpunim, mbikëqyrje. Po ashtu kërkoi që në njëjtin tekst të figuroin edhe institucionet tjera siç janë: Parlamenti Evropian, Këshilli Evropian, EU Lex si dhe të standardizohet terminologjia e institucioneve .

Përfundim:

Fushëveprimtaria u miratua me propozimin dhe vërejtjet e bëra.

3. Nxjerrja e Rregullores së punës së Komisionit

Zylfije Hundozi për këtë pikë të rendit të ditës ftoi përfaqësuesin e NDI të prezantoi para anëtarëve të Komisionit draft-rregulloren e punës.

Avni Zuka nga NDI-i tha se gjatë bashkëpunimit të cilin e ka pas NDI-i me Kuvendin e Kosovës dhe në veçanti me Komisionet Parlamentare e ka pa si të nevojshme hartimin e rregullores për Komisionet. Për këtë arsye tha e kemi hartuar një propozim draft rregullor për Komisionet Parlamentare dhe e kemi proceduar në Komisionin për Legjislacion, rregullorja është në procedurë e sipër. Ai shtoi se duke u bazuar në specifikat e veta dhe në bazë të programit të punës secili Komision mund ta adaptointe rregulloren.

Sabri Hamiti tha se rregullorja e Komisioneve është universale .

4. Të ndryshme

a) **Draft plani i punës**

Zylfije Hundozi hapi diskutimin për draft planin e punës së Komisionit për Integritet Evropian dhe ftoi anëtarët e Komisionit që të japin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre.

Nait Hasani tha se në këtë projekt plan në disa fusha ka disa aktivitetet të cilat nuk përputhen me kronologjinë e kohës psh. projektligji për Pyjet i cili është paraparë për muajin qershor. Ai shtoi se, siç e dimë në muajin qershor fillon djegia e pyjeve, me qëllim të parandalimit të djegies së pyjeve konsideroi se duhet të bëjmë një kërkesë Qeverisë që të sjell këtë ligj më herët.

Po ashtu shtoi se, Projektligji për Armët është paraparë në muajin qershor, ky projektligj sa më herët që të vijë për miratim aq më shumë ka me i kursyer jetët e njerëzve, sepse i bënë përgjegjës ata që lypin leje dhe ata që dëshirojnë të marrin lejen. Personi që ka leje

është përgjegjës ndaj veprimit me armë ndërsa personi që kërkon me marr lejen tenton të mos bëjë veprime që e ndalojnë marrjen e lejes dhe kështu kemi mundësi që për dy muaj së paku 50% të rasteve me i ndal . Ai tha se, konsideroi që dy ligjet duhet të vinë në prill ose mars sepse nëse i lejojmë të vijnë në qershor dy muaj i kemi në lexim të parë, leximi i dytë del në fund të gushtit kështu që do të jetë vonë. Sa i përket Ligjit për Mërgatën ai tha se, në fluksin më të madh të mërgatës e kemi në muajt qershor, korrik dhe gusht ndërsa projektligji është paraparë për muajin shtator do të thotë se ne nuk po i paraprijmë po ne po shkojmë prapa veprimeve të tyre. Në vazhdim shtoi se është mirë që edhe ky projektligj të miratohet para se të vijë mërgata dhe mundësisht të hapen zyre të veçanta që të ju mundësohet rregullimi dhe vazhdimi i dokumenteve të udhëtimit në mënyrë që mos i humbin pushimet duke bërë përpjekje për ti rregulluar dokumentet.

Zylfije Hundozi në përgjigjeje të deputetit Hasani tha se propozimi yt është që Komisioni të kontaktoi me Qeverinë që të bëhet spostimi i këtyre ligjeve për më herët.

Naser Rugova shpjegoi se ne e kemi marrë Strategjinë legjislative nga Qeveria, Parlamenti e ka miratuar dhe duhet proceduar tutje. Ai shtoi se, në Komision për këto ligje që kolegu Nait i përmendi duhet të diskutojmë se pari me Qeverinë dhe me Komisionet funksional raportuese që janë kompetent në Kuvendin e Kosovës sepse Komisioni për Integritet Evropian vetëm e jep pëlqimin dhe rekomandon Kryesisë dhe Komisionit gjegjes për përputhshmërinë e këtyre propozim ligjeve me legjislacionin e Bashkimit Evropian, por për këtë Kryetarja e Komisionit me Nënkryetaret mund të zhvilloi biseda zyrtare qoftë me Komisionet gjegjëse funksionale, përfaqësuesit e Qeverisë dhe me Kryesin e Kuvendit si organ politik që e ka përgjegjësin për mbarëvajtjen dhe respektimin e asaj agjende legjislative që është miratuar në parim.

Ndërsa sa i takon programit të punës ai tha është program i kapshëm. Ai propozoi që të jetë një vizitë në Parlamentin Evropian, pse jo edhe në vendet e rajonit të cilat kanë bërë një ecje cilësore konform Planit të Partneritetit evropian dhe integriteteve evropiane por gjithnjë duke i pasur parasysh mundësitë financiare.

Sabri Hamiti tha sa i përket agjendës legjislative pajtohem me kolegun Rugova. Ai shtoi se, Komisioni për Integritet nuk është Komision funksional në Kuvendin e Kosovës sa i përket legjislacionit, por është le të themi një tip Komisioni që mbikëqyrë secilën pikë të legjislacionit që ta bëjë sa më të kapshëm dhe krahasueshëm me legjislacionin evropian. Deri tash tha nuk shoh në rregullore se ndonjë ligj do të vjen direkt në këtë Komision në mënyrë që të japë mendimin si Komision funksional legjislativ. Kjo në të njëjtën mënyrë e bënë më të lirë komisionin nga aspekti legjislativ, e në të njëjtën kohë e bënë më të angazhuar se duhet të merret me të gjitha ligjet dhe nuk merret në mënyrë specifike me asnjërin. Ndërsa puna legjislative tha se nuk është mirë të insistohet të qitet nëpër kohë dhe data se nuk varet prej nesh .

Sa i përket punës së komunikimit ai tha se absolutisht që ka nevojë për komunikime por shtoi se ato duhet të shikohen me masë dhe me nevojat. Në regjion ekziston lidhja e komisioneve për integritet. Ai tha se tash që kemi status nuk do duhej të kishim pengesa që të anëtarësohemi. Ai njoftoi se kanë qenë dy herë të pranishëm si vëzhgues një herë në Zagreb dhe një herë në Shkup dhe se tubimet mbahen çdo gjashtë muaj, sillen në program ku problemet pak a shumë i kanë të ngjashme të gjitha shtetet e rajonit pa marrë

para sysh se ne ecje Kroacia si formacion është shume me afër. Sa i përket vizitave në Shqipëri tha se, nuk duhet të ngutemi shume për shkak se ata i kane bërë një ftesë Komisionit për Pune të Jashtme kështu që është mirë të bëjmë një orar të lëvizjeve në mënyrë që mos ti përsërisim gjërat.

Ai tha se në princip pajtohem që si komision te kontaktojmë me komisionet homologe të rajonit dhe u pajtua me Edita Tahirin qe synimi jonë është komunikimi me Parlamentin Evropian.

Edita Tahiri propozoi që në kuadër të planit te punës të kemi çdo tre muaj një lloj raportimi për pozitën e Kosoves në institucionet evropiane përfshire këtu Bashkimin Evropian në nivelin ekzekutiv, në Parlamentin Evropian, në Këshillin e Evropes. Ajo shtoi se, OSBE-ja dhe NATO kanë mekanizma parlamentar por tha se është mirë që Kryetarje e Komisionit dhe Sabri Hamiti të diskutoin në mënyrë që të mos bëjmë interferime si do ti ndjekim seancat . Lidhur me këtë propozoi që referues të jenë një përfaqësues i Qeverisë së Kosoves, një përfaqësues i zyrës se Bashkimit Evropian në Kosovë dhe një ekspert i pavarur i cili merret me këto çështje, në mënyrë që të dimë ku te synojmë dhe ku janë ato ngecje qe ne si komision të synojmë. Po ashtu tha është mirë ti kemi në dispozicion rezolutat, së paku këto të vitit 2007 që të kemi kontinuitet. Ajo njoftoi se diçka është miratua në Këshill të Evropës me inicimin e lordit Jon Ston. Lidhur me komunikimin Ajo shtoi se, ky komision jo vetëm që duhet të bëjë një vizitë në Parlamentin Evropian por duhet të bëjmë çmos që të marrim pjesë në të gjitha seancat e institucioneve parlamentare evropiane. Edhe pse ne nuk kemi status aty kjo nuk pengon që ne të jemi atje dhe të lobizojm. Këtu në rregulloren e punës tha pash se nga ne si komision kërkohet një propozim për buxhetin por është esenciale meqë kemi dy komisione te merremi vesh cilën fushë do ta mbulon Komisionin për Punë të Jashtme, cilin institucion po e mbulon komisioni ynë. Ajo njoftoi se katër herë në vit janë seancat, dhe se dikur është punuar në këto drejtime nga koha kur kemi qene ne lëvizjen paqësore LDK por edhe në Qeverinë e Kosoves, ajo tha se unë i kam udhëhequr krejt këto procese. Ndërsa shtoi se, tash ne një pozite të këtyllë mendoj se nuk guxojmë te mungojmë.

Lutfi Haziri tha se Qeveria ka miratuar një dokument voluminoz që quhet Strategjia. Ai tha se është një dokument bazik që institucionet e Kosoves dhe anëtarët e Komisionit për Integritet duhet ta kenë dhe se duhet të angazhohemi sepse aty parashihet një strukturë dhe një rol kritik i Komisionit për Integritet Evropiane. Ndërsa sa i përket rolit të komisionit ai shtoi se, Komisioni e ka rolin e vete sikurse që e kanë rolin e vetë institucionet tjera në mënyrë që të koordinohet sa ma mirë me Agjensionin për Integritet Evropiane. Propozoi që Agjensionin të jenë një lloj hallkë në mes nesh, Qeveris dhe institucioneve tjera për të ndihmuar zhvillimin e politikave dhe rolin e komisionit. Ai propozoi që në mbledhjen e ardhshme të shpërndahet dokumenti në mënyrë që brenda dinamikës se parapamë për këtë vit me përputh edhe strategjinë qe është paraparë.

Sabiha Shala nga AIE tha se nëse është fjala për Strategji dhe Pako Reformuese për integritet ende nuk është miratua nga Qeveri kështu që nuk mundet të prezentohet si draft. Ajo propozoi që Komisioni të dërgoi një shkresë Qeveris me të cilën do të kërkohej përshpejtim i miratimit të Strategjis .

Fatmir Rexhepi tha se ne ende jemi ne fillim te punës dhe si komision i ri duhet te hulumtoim përvojën rreth organizimit dhe funksionimit te vete komisionit. Ai tha se ndër objektivat qe janë planifikuar për vitin 2008 po shoh dy pjese brenda këtij drafti. Një pjesë e cila ka te beje me legjislativin dhe që ka një numër shume te madhe te projektligjeve qe janë dhënë ne këtë agjendë. Por ajo qe i mungon është objektivi tjetër, pra programin e pjesëmarrjes se këtij komisioni ne kuadër te vizitave ose bashkëpunimit, diskutimeve, kontakteve me agjensionet e BE-s apo institucioneve te tjera te vendeve ne tranzicion për te pare edhe përvojën dhe për te mundur ne te punojmë më mirë. Sa i përket bashkëpunimit me vendet e rajonit ai shtoi se, prej muajit maj deri ne fund te vitit mungon kjo pjese dhe konsideroj se duhet te parashihet ne mënyrë qe ne te marrim përvojat ne përgatitjen e atyre reformave qe i takon komisionit parlamentare ne fushat e caktuara dhe te cilat kane te bëjnë me plotësimin e standardeve drejt atyre kritereve ne fazat e caktuara te vendit tone ne institucionet deri te Parlamenti Evropian. Ai propozoi që për ti përmbush këto politika zhvillimore ne infrastrukturë, energjetik dhe politika te tjera në pjesën prej majit e tutje si kalendar si agjendë duhet te përfshin diçka sepse konsideroj se është e zbrazet.

b) Ofertat e OJQ-ve për mbështetjen e Komisionit

Zylfije Hundozi njoftoi anëtarët e Komisionit për disa oferta të organizatave joqeveritare për ndihmë këtij Komisioni dhe mbetet që ne të vendosim se a do të bashkëpunojm me to.

Edita Tahiri përkrahu bashkëpunimin me OJQ-të mirëpo kërkoi që te gjitha këto OJQ dhe mekanizma që duan të bashkëpunojnë me Komisionin të ndajnë fushëveprimtarin në mënyrë që të mos vjen deri te përsëritja e angazhimeve dhe ne të dimë se cilat fusha cila OJQ i mbulon dhe te dimë se cilave tju drejtohem.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë

Përfundim

Përkrahi bashkëpunimin me të gjitha organizata joqeveritare të cilat kanë ofruar mbështetjen Komisionit.

c) Miratimi i preambulës së fushëveprimtarisë

Zylfije Hundozi njoftoi anëtarët e Komisionit me propozimin e preambulës së programit të përgatitur nga deputetja Edita Tahiri.

Nait Hasani propozoi që preambula të ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë që është deklarative të hiqet dhe pjesa e fjalëve “Misioni dhe programi i punës” të fshihen dhe zëvendësohen me fjalën “Qëllimi”

Në vazhdim diskutuan deputetët Nait Hasani, Lutfi Haziri, Sabri Hamiti dhe Njomza Emini.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë

Përfundim

Miratohet preambula e Programit të Komisionit me ndryshimet e propozuara.

Mbledhja përfundo në ora 11:35 min.

Procesmbajtësi
Adelina Demolli

Kryetare e Komisionit
Zylfije Hundozi